



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:181424

Datë: 10.07.2020

Numri i dokumentit: 01018825

C.nr. 1002/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Gjyqtari Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit R Z nga fshati R K. Pejë, kundër të paditurit Komuna e Pejës, me bazë juridike pagesë e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, vlera e kontestit 3813,80 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesorë me datë 23.06.2020, jashtë seancës me datë 10.07.2020, bie këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Pejës - D K A në Pejë, që paditësit R Z nga Peja, të i bëjë kompensimin e shumave siç vijon dhe atë :

- në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, të i paguajë shumën prej 2093.18 euro,
- në emër të kompensimit të pagave përcjellëse shumën prej 1720.62 euro,

për të dyja shumat e gjykuara me kamatë në lartësi prej 8 % , duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri te pagesa definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R Z nga fshati R K. Pejë me datën 21.08.2019 në këtë gjykatë nëpërmes të autorizuarit të tij av. Ali Lajçi ka parashtruar padi me bazë juridike kompensim i tri pagave përcjellëse në pension dhe shpërblim i tri pagave jubilarë.

E paditura Komuna e Pejës – DKA në Pejë në afatin ligjor ka parashtruar përgjigje në padi duke e kundërshtuar si të pabazuar padinë ashtu edhe kërkesëpadinë e paditësit sepse është pa mbështetje ligjore, juridike dhe faktike, duke mos paraqit me asnjë provë pretendimet e tij se e paditura ka obligim material të shumës së kërkuar,

duke theksuar që të paditurit i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë procedurë gjyqësore, duke cekur se kërkesa për pagesën e pagave jubilarë është parashkruar ngase sipas dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.06.2014, i punësuari në realizmin e pagave jubilarë për çdo 10vjet përvojë pune, kurse në afatin ligjor për një kërkesë të tillë është 3 vite pas kalimit të çdo periudhe dhjetë vjeçare dhe një e drejtë e tillë nuk mund të realizohet pas pensionimit në mënyre retroaktive, ndërsa sa i përket pagave përcjellëse padinë dhe kërkesëpadinë e tij duhet të e drejtojë ndaj Ministrisë së A si garantuese e obligimeve financiare, duke kërkuar që të refuzohet si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit.

Në seancën e datës 23.06.2020 ishte i pranishëm vetëm paditësi R Z, kurse nga pala e paditur nuk ishte i pranishëm askush edhe pse nga fletkthesa e datës 04.06.2020 konstatohet se pala e paditur e ka pranuar fletkthesën ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj seanca është mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur.

Paditësi në fjalën përfundimtare të seancës së datës 23.06.2020, deklarojë se nga provat e administruara në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar bazueshmëria e kërkesëpadisë prandaj i propozojë gjykatës që e njëjta kërkesëpadi ta aprovojë si të bazuar, shpenzimet e procedurës i kërkojë për çka në afat prej 3 ditësh Gjykatës do ti dorëzojë parashtresën për shpenzimet e specifikuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në shqyrtimin kryesorë ka administruar këto prova: aktvendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore e datës 02.02.2016, përgjigja e DA në Pejë e datës 12.02.2019 nr.568/29, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU Rilindja në Trestenik me numër protokolli 132/16 e datës 04.02.2016, vërtetimi i lëshuar nga DKA nr.563/27 i datës 18.04.2016, lista e rrogave e datës 01.01.2016, ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes civile në emër të R Z lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Pejë me datë 03.02.2016, Ekspertiza e ekspertit Avdi Shala e datës 13.03.2020.

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko - kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vërtetuar gjendjen faktike siç vijon : Nuk është kontestuese fakti se paditësi R Z nga fshati R K. Pejë ka qenë i punësuar në shkollën fillore të mesme të ulët "Ali Kelmendi" në fshatin N K. Pejë deri me datën 25.02.2016, ashtu që po me këtë ditë i ka përfunduar automatikisht marrëdhënia e punës për shkak të mbushjes së moshës mandatorë të pensionit me 65 vjet, me përvojë pune 43 vite.

Nuk është kontestues fakti se pas arritjes së moshës së pensionimit paditësi i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së A në Pejë duke kërkuar që të rimbursohet për tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar duke u mbështetur në dispozitat e nenit 2 dhe nenit 36 par 9 nën paragrafi 9.3 dhe par 10 të Kontratës Kolektive të A Para universitar e nënshkruar nga MASHT-i dhe SBASHK-u me datë 11.04.2014 dhe e zbatueshme me 01.01.2015, ashtu që neni 2 përcakton se "dispozitat janë të zbatueshme

për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të A Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendrës së kompetencës dhe institucionet e A të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilat janë anëtare të SBASHK-ut) dhe nenit 36 par 9 i kësaj kontrate i cili përcakton se për "punëtorët që dalin në pension përfshijnë pensionin jubilar në vlerë prej 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, dhe në të njëjtin nen par 10 përcaktohet se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagën përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi duke e aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar pasi që të dyja palët (SBASHK-u dhe Ministria e A, Shkencës dhe Teknologjisë) kanë lidhur marrëveshje kolektive në mes tyre, duke pranuar të drejtat dhe obligimet të dyja palët nënshkruese, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 90 par 1 të Ligjit të Punës që Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet "organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit e tij dhe organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve", par 2 Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në " nivel vendi, nivel të degës, nivel të ndërmarrjes", par 3 Marrëveshja kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës, par 4 "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3)vjet", par 5 "Marrëveshja e tillë Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive" e përderisa parashihet me Ligj të punës, atëherë vlen për edhe për paditësin pasiqë të drejtat kanë qenë të përcaktuara me këtë Marrëveshje të lidhur në mes të Ministrisë së A dhe SBASHK-ut.

Lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e vërtetojë për paditësin nga ekspertiza e datës 13.03.2020 e ekspertit financiar Avdi Shala, ndërsa lartësinë e shpërblimit jubilarë e vërtetojë nga lëshimi i vërtetimit të stazhit të punës nga ana e Shkollës së Mesme të Ulët 'R në fshatin Terstenik për vitet e përvojës së punës, ashtu që vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nuk pajtohet me pretendimin e palës së paditur që garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare nga kërkesëpadia e paditësit është Ministria e A dhe Ministria e Financave lidhur me të drejtat e të punësuarve në sektorin e A para universitar që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, sepse në Ligjin për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 të datës 2008, në Kreun II (Përgjegjësitë dhe Kompetencat e zgjeruara të Komunave) gjegjësisht nenin 4 (kompetencat dhe kompetencat e Zgjeruara të Komunave) par 1 ashtu që përcaktohet që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e A publik, parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimeve dhe administratorëve, dhe në nenin 16 dhe 17 paragrafi h i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ashtu që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e

përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushën e përcaktuar nën pikën h "ofrimin e A publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të A, e duke u mbështetur në të lartcekurat obligimi bie mbi Komunën e Pejës, që të bëjë realizimin e kërkesave të paditësve.

Gjykata bëri edhe vlerësimet dhe pretendimet tjera të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk qëndrojnë, pasi që Kontrata Kolektive e cek qartë që punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit për vitet në shërbim, do të thotë që përderisa kontrata kolektive ka qenë e zbatueshme në vitin 2015, paditësi ka dal në pension në vitin 2016, prandaj e gëzon të drejtën e parashikuara në këtë kontratë e në rastin konkret gëzon të drejtën në shpërblim jubilar. Vendimin mbi kamatën gjykata e ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 par 1 dhe par 2 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendosi që secila palë të i bartë shpenzimet e veta sipas nenit 450 të LPK-së, pasi që pala paditëse nuk ka sjellë listë të shpenzimeve sipas nenit 463 të LPK-së.

Prandaj nga të lartcekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË me datë 10.07.2020

**Gjyqtari
Fatmir Baloku**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa, në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.